



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-038
Prishtinë, më 23 korrik 2018, në orën 9:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 23 KORRIK 2018

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Aida Dërguti, Slavko Simiq dhe Mufera Srbica-Shinik, nënkryetarë të Kuvendit.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Avni Bytyqi dhe Valmir Klaiqi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe tri (3) pika shtesë, të cilat i miratoi Kryesia e Kuvendit.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mëparshme të Kryesisë së Kuvendit,
2. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mëparshme të Kryesisë së Kuvendit

Kryesia i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 22 qershor dhe 6 e 9 korrik 2018.

2. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave

1. Nisma legislative “Projektligji për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së” hartuar nga kryetari i Kuvendit, mbështetur edhe nga 25 deputetë të Kuvendit

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e nismës legislative për Projektligjin për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me nismën legislative “Projektligji për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së”, si dhe të përgatisë Deklaratën e ndikimit buxhetor dhe Deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së të këtij projektligji në afatin prej një (1) muaji nga dita e pranimit.

2. Nisma legislative “Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit, hartuar nga Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e nismës legislative për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me nismën legislative “Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit”, si dhe të përgatisë Deklaratën e ndikimit buxhetor dhe Deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së të këtij projektligji në afatin prej një (1) muaji nga dita e pranimi.

3. Nisma legislative “Projektligji për plotësim-ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës”, propozuar nga GP i Lëvizjes Vetëvendosje, e përfaqësuar nga deputetja Albulena Haxhiu

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e nismës legislative për Projektligjin për plotësim-ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me nismën legislative “Projektligji për plotësim-ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës”, si dhe të përgatisë Deklaratën e ndikimit buxhetor dhe Deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së të këtij projektligji në afatin prej një (1) muaji nga dita e pranimi.

4. Nisma legislative “Projektligji për transmetuesin publik të Kosovës”, hartuar nga Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e nismës legislative për Projektligjin për transmetuesin publik të Kosovës, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me nismën legislative “Projektligji për transmetuesin publik të Kosovës”, si dhe të përgatisë Deklaratën e ndikimit buxhetor dhe Deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së të këtij projektligji në afatin prej një (1) muaji nga dita e pranimi.

5. Nisma legislative “Projektligji për referendum”, hartuar nga deputeti Faton Topalli, mbështetur nga 11 deputetë të Kuvendit

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e nismës legislative për Projektligjin për referendum, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me nismën legjislative “Projektligji për referendum”, si dhe të përgatisë Deklaratën e ndikimit buxhetor dhe Deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së të këtij projektligji në afatin prej një (1) muaji nga dita e pranimit.

6. Propozim-rezoluta e deputetes Donika Kadaj-Bujupi, e mbështetur edhe nga shtatë (7) deputetë të GP të AAK-së, në lidhje me çështjen Liberalizimi i vizave para dialogut

Kryesia vendosi që Propozim-rezoluta e lartshënuar në lidhje me çështjen Liberalizimi i vizave para dialogut të radhitet në rend dite për seancën plenare të radhës.

7. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për tremujorin e parë të vitit 2018

Kryesia, pasi e shqyrtoi raportin e shpenzimeve të Kuvendit për tremujorin e parë të vitit 2018, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për tremujorin e parë të vitit 2018, sipas pasqyrave të paraqitura nga Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Administrata e Kuvendit.

8. Propozimi i deputetit Milaim Zeka, mbështetur edhe nga 5 deputetë për formimin e Komisionit Hetimor në lidhje me gjendjen në PTK dhe Vala

Kryesia, pasi e shqyrtoi propozimin e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohet nga grupet parlamentare që para mbledhjes së radhës të Kryesisë t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit Hetimor Parlamentar, sipas propozimit të deputetit Milaim Zeka, mbështetur edhe nga 5 deputetë të tjerë, për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me gjendjen në PTK dhe Vala.

2. Përbërja e komisionit do të jetë me 11 anëtarë: grupet parlamentare të LDK-së, të LVV-së dhe PSD-së propozojnë pesë (5) anëtarë, në mesin e tyre propozojnë kryesuesin, si dhe grupet parlamentare të PDK-së, AAK-së, Listës serbe, Nismës Socialdemokrate dhe “6+” propozojnë gjashtë (6) anëtarë, në mesin e tyre propozojnë zëvendëskryesuesin, sipas propozuesit.

9. Kërkesa e deputetes Donika Kadaj-Bujupi, mbështetur edhe nga 7 deputetët nënshkrues nga GP i AAK-së për debat parlamentar në lidhje me shtesat e fëmijëve

Kryesia vendosi që kërkesa e lartshënuar të radhitet në rend dite për seancën plenare të radhës.

10. Kërkesa e ish-deputetëve të Kuvendit të Kosovës për inicimin e ligjit nga Kuvendi për rregullimin e statusit të tyre

Kryesia, pasi diskutoi për kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkesa e 41 ish-deputetëve të Kuvendit të Kosovës të legjislaturave të mëparshme i dërgohet Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit.

11. Vendimi i Ministrisë së Financave për caktimin e tarifave për shpenzimet e udhëtimeve jashtë vendit

Kryesia, pasi diskutoi për Vendimin e Ministrisë së Financave për caktimin e tarifave për shpenzimet e udhëtimeve jashtë vendit, nxori këtë:

V E N D I M

1. Zbatohet Vendimi nr. 30/2018, datë 19.06.2018, i ministrit të Financave për aprovimin e tarifave të rishikuara për udhëtimet jashtë vendit, nga data 1 korrik 2018.

2. Shfuqizohen të gjitha aktet e mëparshme që kanë rregulluar tarifatat e shpenzimeve dhe mëditjeve për udhëtime jashtë vendit.

12. Kërkesa e Prishtina Internacional Film Festival për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Prishtina Internacional Film Festival mbështetet financiarisht në shumën prej 3,000 euro për organizimin e festivalit PRI-FILM-FEST.

13. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve lidhur me anulimin e udhëtimit zyrtar të dy anëtarëve të delegacionit nga Kuvendit i Kosovës në Paris (Francë)

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet kërkesa për mbulimin e shpenzimeve për rezervimin e akomodimit të deputetëve Teuta Rugova dhe Ahmet Isufi në shumën prej 1,270.12 eurosh, në lidhje me anulimin e udhëtimit zyrtar në Paris (Francë), të paraparë nga 17 deri më 19 qershor 2018.

14. Kërkesa e OJQ-së “Toka” për mbulimin e qirasë për periudhën 1 korrik deri më 31 shtator 2018

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet kërkesa e OJQ-së “Toka” për pagesën e qirasë për periudhën prej 1 korrik deri më 30 shtator 2018, në shumën prej 2,637.36 eurosh.

15. Kërkesa e OJQ-së “Multiethnic culture of Kosovo” për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

OJQ-ja “Multiethnic culture of Kosovo” mbështetet financiarisht në shumën prej 1,000 eurosh për projektin e organizimit të Festivalit të 5-të për promovimin e kulturës, gjuhës dhe traditës rome në Kosovë.

16. Shqyrtimi i kërkesës së shoqatës për emancipimin e femrës ALMA për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Shoqata për emancipimin e femrës ALMA mbështetet financiarisht në shumën prej 1,000 eurosh për projektin “Fuqizimi i grave në politikë”.

17. Kërkesa e organizatës: Emancipim, Mbrojtje, Avancim (EMA) për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

OJQ-ja Emancipim, Mbrojtje, Avancim (EMA) mbështetet financiarisht në shumën prej 1 000 eurosh për projektin “Kampanja informuese për qytetarët e Republikës së Kosovës për Parlamentin e Kosovës”.

18. Kërkesa e Denur Paçaku, djali i ish-deputetit të ndjerë Kujtim Paçaku, për kompensimin e shpenzimeve të bëra me rastin e ndërrimit të jetës së babit të tij

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Denur Paçaku mbështetet financiarisht në shumën prej 1,375 eurosh për mbulimin e shpenzimeve të varrimit të ish-deputetit të Kuvendit të Kosovës, të ndjerit Kujtim Paçaku.

19. Kërkesa e zyrtarit të Kuvendit, Hashmet Baxhaku, për ndihmë financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Zyrtari i Administratës së Kuvendit të Kosovës, z. Hashmet Baxhaku, mbështetet financiarisht në shumën prej 1 500 eurosh për mbulimin e shpenzime të trajtimit shëndetësor të djalit të tij.

20. Kërkesa e Furtuna Aliut për mbështetje financiare

Kryesia e përkrahu në parim kërkesën e lartshënuar, por për sqarime shtesë të kërkesës në lidhje me saktësimin e shumës së kërkuar vendosi që ajo të shqyrtohet edhe një herë në mbledhjen e radhës të Kryesisë së Kuvendit.

21. Njoftimi lidhur me mbledhjen V të Komisionit Parlamentar për Stabilizim-Asociim, BE-Kosovë, që do të mbahet në Kuvendin e Kosovës, më 17-18 shtator 2018

Kryesia, pasi u njoftua lidhur me mbledhjen V të Komisionit Parlamentar për Stabilizim-Asociim BE-Kosovë, mori këtë:

V E N D I M

Lejohet mbajtja e mbledhjes V të Komisionit Parlamentar për Stabilizim-Asociim BE-Kosovë në sallën plenare të Kuvendit nga 17 deri më 18 shtator 2018, si dhe të mbulohen shpenzimet për realizimin e mbledhjes, sipas kërkesës nr.06/1774/Do-982, datë 19.07.2018.

22. Njoftimi i deputetëve Veton Berisha dhe Etem Arifi për bashkëngjitjen e tyre në GP të Nismës Socialdemokrate

Kryesi u njoftua me shkrim nga deputetët Veton Berisha dhe Etem Arifi se ata nga data 12 korrik 2018 i janë bashkëngjitur Grupit Parlamentar të Nismës Socialdemokrate.

23. Njoftimi i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Gjermani

Kryesia u njoftua me shkrim nga komisioni i lartshënuar lidhur me realizimin e udhëtimit zyrtar në Gjermani prej 7 deri më 8 qershor 2018.

* * *

Pikat shtesë:

1. Kërkesat e kryetarëve të komisioneve parlamentare për lejimin e tejkalimit të shpenzimeve të bufesë

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr. 03-V-020/2008, datë 20 mars 2008, për caktimin e shumës së shpenzimeve për telefoni dhe shërbime të bufesë

1. Miratohen kërkesat e kryetarëve të komisioneve parlamentare për lejimin e tejkalimit të shpenzimeve të bufesë, në shumën 1 275,00 euro, për periudhën janar - korrik 2018.

2. Pika III e Vendimit nr. 03-V-020/2008, datë 20 mars 2008, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim: “Shpenzimet për shfrytëzimin e bufesë gjatë mbledhjes së komisionit parlamentar lejohen deri në 150 euro në muaj”.

3. Fatura për shpenzime nga pika 2 e këtij vendimi nënshkruhet nga kryetari i komisionit, në mungesë të kryetarit, kryesuesi i mbledhjes dhe çdo tejkalim nga shuma e lejuar zbritet nga pjesa e kompensimit mujor për pjesëmarrje në mbledhje të komisionit.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

2. Furnizimi i pajisjeve për sallën plenare

Kryesia, pasi diskutoi në lidhje me furnizimin e pajisjeve për sallën plenare të Kuvendit të Kosovës, mori këtë:

V E N D I M

1. Projekti, “Furnizimi, montimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve për Sallën Plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës”, i planifikuar nga Kuvendi për vitin 2018, bartet në Ministrinë e Administratës Publike.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit që të lidhë Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Administratës Publike për zhvillimin e procedurës së prokurimit për Projektin nga pika 1 e këtij Vendimi.
3. Ministria e Administratës Publike të zhvillojë procedurën prokurimit për Projektin “Furnizimi, montimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve për Sallën Plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës”, në pajtim me marrëveshjen nga pika 2 e këtij Vendimi, si dhe për çdo fazë të prokurimit të njoftojë Kryesinë e Kuvendit.

3. Shqyrtimi i kërkesës për mbulim të shpenzimeve të biletave të udhëtimit lidhur me anulimin e udhëtimit zyrtar të deputetit Elmi Reçica për në Panama
Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet kërkesa për mbulimin e shpenzimeve të biletës së udhëtimit në shumën prej 3,245.50 euro, për shkak të anulimit të udhëtimit zyrtar të deputetit Elmi Reçica, të paraparë për në Panama, nga 25 deri më 30 qershor 2018.

Në fund, nënkryetarja e Kuvendit, znj. Mufera Srbica-Shinik, ngriti shqetësim në lidhje me shumat mujore të shpenzimeve të bufesë të paraqitura në fatura.

Në lidhje me çështjen e ngritur nga nënkryetarja e Kuvendit, znj. Mufera Srbica-Shinik, kryetari kërkoi nga Administrata e Kuvendit që ta përgatisë një informatë lidhur me këtë çështje dhe ta njoftojë në mbledhjen e radhës Kryesinë e Kuvendit. Diskutimi i plotë i kryetarit të Kuvendit është dhënë në transkript.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 9:55 minuta.

Kryetari i Kuvendit:
Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*